



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR PËRCAKTIMIN E KOMPENSIMIT TË**  
**AKSIONARËVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE LOKALE**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0210515/20, të dt. 13.11.2020.

**II.**

Pika III e vendimit të cekur, ndryshon dhe në të thuhet:

Mjetet për kompensimin e aksionarëve do të merren nga ndërmarrjet publike lokale ku ata shërbejnë.

Pika V e vendimit të cekur, ndryshon dhe në të thuhet:

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen ndërmarrjet publike lokale të Komunës.

**III.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-030/01-27297/21, më 11.02.2021**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

